



BASHKIA KORÇË



Politika e Mbrojtjes



BASHKIA KORÇË

Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen Bashkia Korçë 2021-2023

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet shoqatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS dhe Bashkisë Korçë, e lidhur me datë 13.07.2021 me nr.prot 6013 dhe nr.101 prot, (NISMA) datë 15.07.2021 për zbatimin e projektit “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (*Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror*) me mbështetje të Fondit Social (2021-2023), ekipi i Nisma ARSIS ka hartuar politikat e mbrojtjes për Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen në Bashkinë Korçë. Ky dokument ka në fokus politikat dhe procedurat përkatëse të cilat përshkruajnë angazhimin e SHMFF Korçë për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve dhe të rriturve nga çdo formë dëmtimi apo abuzimi. Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen sigurojnë mbrojtje, përkrahjen e të drejtave dhe mirëqënies për çdo fëmijë, të ri dhe familjet e tyre të fëmijëve dhe të rriturve. Qëllimi i kësaj politike është të sigurojë që shërbimet që ofrohen në SHMFF Korçë janë të sigurta për fëmijët dhe të rriturit në situata vulnerabël, duke promovuar ndërgjegjësime dhe duke minimizuar rrezikun e dëmeve me të cilat fëmijët dhe të rriturit vulnerabël, mund të përballen nga punonjës, përfaqësues, programe apo aktivitete.

Hartimi i dokumentit bazohet në nenin 4 të marrëveshjes dhe në zbatim të aktivitetit “*Hartimi i të gjitha politikave të mbrojtjes së klientëve (përfituesve) dhe punonjësve të shërbimit.*”

Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen (SHMFF) janë ngritur pranë Bashkisë Korçë në kuadër të projektit “Ngritja e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (*Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror*) të financuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” në shtator të vitit 2021. SHMFF KORÇË ndihmon përmes qasjeve inovative dhe zgjidhjeve praktike, të qëndrueshme në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për fëmijët në nevojë, familjeve dhe komuniteteve të tyre.

Vizioni i SHMFF KORÇË: Çdo fëmijë, i ri, grua dhe familje në Bashkinë Korçë dhe më gjerë t’i sigurohet e drejta për mbrojtje, zhvillim dhe pjesëmarrje.

Misioni i SHMFF KORÇË: Të promovojë të drejtat, të sigurojë shërbimet dhe zgjidhje të qëndrueshme për fëmijët, të rinjtë dhe familjet në situata vulnerabël, si dhe për komunitetet e marginalizuara rome/egjiptiane dhe grupe të tjera të shoqërisë.



BASHKIA KORÇË

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)

Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

2

Përmbajtja

Përkufizime	4	
Hyrje 6		
Deklarata e angazhimit dhe parimeve udhëheqëse	6	
Politikat	8	Implementimi
i Politikës dhe Procedurat	9	
1. Vlerësimi i Rrezikut dhe Menaxhimi	9	
2. Rekrutimi i Sigurt për Fëmijët	9	
3. Vullnetarët dhe vizitorët	10	
4. Kodi i sjelljes	11	
5. Edukimi, Trajnimi dhe Mbështetja	12	
6. Komunikimi Child-Safe	13	7. Krijimi i
programeve dhe Implementimi i tyre.....	13	
8. Raportimi dhe Përgjigjja ndaj shqetësimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve	14	
Menaxhimi i Politikave	17	
1. Rolet dhe Përgjegjësitë	17	
2. Monitorimi i Politikës	18	
3. Komunikimi dhe Angazhimi ndaj Politikës	18	
4. Rishikimi i Politikës	19	
Shtojca 1: Formati i raportimit dhe regjistrimit për politikën e mbrojtjes për fëmijët dhe të rriturit	20	
Shtojca 2: Forma e miratimit të informuar për Prindin/Kujdestarin Ligjor	23	
Shtojca 3: Procedurat e ankimimit	25	
Shtojca 4: Udhëzime për përdorimin e imazheve të fëmijëve/të rriturve	27	
Shtojca 5: Deklarata për stafin dhe konsulentët e SHMFF KORÇË	30	
Shtojca 6: Formati i Vlerësimit të Rrezikut	31	
Shtojca 7: Deklarata për vizitorët	32	
Shtojca 8: Termat e referencës për pikën e kontaktit për politikën e mbrojtjes	33	



Përkufizime¹

- **Fëmijë** - është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.
- **Abuzimi i fëmijës** - "Abuzimi apo keqtrajtimi i fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin seksual, lënien pas dore apo trajtimin neglizhues, shfrytëzimin e fëmijës për qëllime përfitimi apo çdo lloj tjetër që shkakton dëmtim aktual apo të mundshëm të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënie përgjegjësie, besimi apo pushteti." (OBSH, 1999).
 - i. **Abuzimi fizik**- Çdo tentativë ose çdo dëmtim fizik apo plagosje e fëmijës, të cilat nuk janë aksidentale dhe që synojnë të shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, sado të lehta qofshin këto. Në abuzimin fizik përfshihen forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja/shtytja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, gjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.
 - ii. **Abuzimi Emocional** (*ndonjëherë i quajtur Abuzim Psikologjik*) - Veprimet që shkaktojnë dëmtime të shëndetit fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës dhe që, ndër të tjera, kanë sjellë si pasojë kufizimin e lirisë së lëvizjes, sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën.
 - iii. **Abuzimi Seksual** - çdo veprim ose aktivitet seksual për përfitim ose kënaqësi seksuale të abuzuesit - pavarësisht nëse fëmija pranon ose jo. Abuzim seksual mund të jetë "me kontakt" siç është përdhunimi ose "pa kontakt" si për shembull detyrimi ose inkurajimi i një fëmije për të parë apo për të qenë pjesë e komunikimeve apo materialeve me përmbajtje pornografike. iv. **Neglizhimi**- Mospërmbushja e vazhdueshme, kur ekzistojnë mundësitë, ose mohimi i vazhdueshëm për t'i siguruar fëmijës ujë të pastër, ushqim, strehim, nevojat higjienike ose mbikqyrje dhe kujdes të cilat shkaktojnë tek fëmija probleme shëndetësore dhe i cënohet zhvillimi.
 - v. **Ndëshkimi trupor** - është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim të fëmija, nga çdo person ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja, shtytja, djegia, goditja, pickimi, gjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, tërheqja e flokëve, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, si dhe çdo veprim i ngjashëm me të. vi. **Neglizhimi i fëmijës** - është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.

¹ - Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"



BASHKIA KORÇË

- Udhëzim nr.10, datë 25.02.2015 për “Mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmën e fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.”
- Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare (ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018)”
- Ligj Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë”



- **Dhunë ndaj fëmijës** - është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.
- **Fëmijë në nevojë për mbrojtje** - është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ i nën moshën e përgjegjësive penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin. *Ligji 18/2017*
- **Mbrojtja e fëmijës** - është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.
- **Pjesëmarrja e fëmijës** - është një proces i vazhdueshëm i pjesëmarrjes dhe përfshirjes aktive të fëmijës dhe respektimin e të drejtës së fëmijëve për të shprehur pikëpamjet e tij dhe për t'u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje që lidhen me të.
- **Sistemi i integruar i mbrojtjes** - është tërësia e akteve ligjore, politike dhe e shërbimeve të nevojshme, në të gjitha fushat, veçanërisht në ato të mirëqenies sociale, edukimit, shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve që shfaqen gjatë zbatimit të tyre. Institucionet përgjegjëse marrin masa konkrete, me qëllim bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësive dhe koordinimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.
- **Situatë emergjence** - është një situatë kritike, e përkohshme ose jo, e shkaktuar nga faktorë shoqërorë, që sjellin apo mund të sjellin dëme të menjëhershme, të rënda ose që dëmtojnë seriozisht jetën, shëndetin apo mirëqenien e individit në rast se nuk merren masa urgjente dhe ndaluese.
- **Mirëqënia e fëmijës** - Mirëqënia e fëmijës është krijimi i një komuniteti të sigurtë për fëmijët.

Hyrje

Politika e Mbrojtjes dhe procedurat përkatëse përdoren në të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet të cilat zhvillohen nga Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen. Kjo politikë njihet dhe thellon angazhimin tonë për të ruajtur sigurinë e fëmijëve dhe të rriturve në situatë vulnerabël dhe për t'i mbrojtur ata nga çdo formë dëmtimi apo abuzimi. Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen sigurojnë mbrojtje për çdo fëmijë, të ri dhe familjet e tyre dhe përkrahjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rriturve dhe mirëqenies së tyre.

Qëllimi i politikës së mbrojtjes dhe procedurave përkatëse është të rregullojë punën e SHMFF në mënyrë që fëmijët dhe të rriturit me të cilët vendoset kontakti (i drejtpërdrejtë ose jo) të jenë të mbrojtur; individëve t'u promovohet mirëqënia dhe veprimet e ndërmarrja gjatë zbatimit të programeve apo aktiviteteve institucionale të mos shkaktojnë dëme tek ta.

Politika e Mbrojtjes është një deklaratë e pritshmërive profesionale që SHMFF ka për punonjësit dhe persona të tjerë të cilët janë në kontakt me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël, përgjatë punës së tyre. Punonjësit, gjatë procesit të punës, duhet të jenë të ndërgjegjshëm për pritshmëritë ndaj tyre dhe duhet

Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (*Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror*)



të mbajnë në vëmendje që “përgjegjësia për të qenë të kujdesshëm” nuk ekziston vetëm në rastet e praktikës së mirë të punës me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël, por duhet të bashkëshoqërohet me nivele të larta përgjegjshmërie dhe duhet të konsiderohet si një detyrë ligjore, për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e nevojshme për këta fëmijë dhe të rritur. Individët për të cilët ofrohen këto shërbime, janë të cënueshëm dhe rrezikojnë të dëmtohen nga një gamë e gjerë burimesh, ndaj punonjësit dhe aktorë të tjerë kanë përgjegjësinë për të minimizuar dhe reduktuar rreziqet e duke i identifikuar ato, duke sfiduar praktikat negative, dhe duke i trajtuar këto burime për individët me të cilët punojnë.

Deklarata e angazhimit dhe parimeve udhëheqëse²

Ky dokument është shkruar në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtar për fëmijët dhe të rriturit në situata vulnerabël, për të drejtat, sigurinë dhe mbështetjen ndaj tyre.

Interesi më i lartë i fëmijës do të jetë angazhimi kryesor në çdo veprim që ndërmerret për të, duke siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur dhe i sigurtë në çdo situatë dhe kontekst.

²Konventa e të Drejtave të Fëmijës (KDF), e cila ofron kornizën ndërkombëtare për të drejtën për mbrojtje nga të gjitha llojet e dhunës (neni 19), diskriminimi (neni 2) dhe format e ndryshme të shfrytëzimit (neni 32,36).

▪ Komenti i Përgjithshëm numër 13 (2011) nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me të Drejtën e fëmijëve për të mos iu nënshtruar asnjë forme dhune, e cila përcakton mbrojtja e fëmijëve dhe adoleshentëve si prioritet absolut.

▪ Standardet e mbrojtjes së fëmijëve, nga rrjeti Keeping Children Safe.

▪ Udhëzimet e politikave për mbrojtjen e fëmijëve, nga Child Fund Alliance. ▪ Ligji

Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë” Ligji

18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Në të gjitha kontekstet të cilat përfshijnë fëmijët dhe mirëqenien e tyre, fokusi i SHMFF-së është interesi më i lartë i fëmijës. SHMFF ka si parim gjithëpërfshirjen dhe beson se fëmijët dhe të rriturit në situata të vulnerabël kanë të drejtën të jenë pjesëmarrës aktivë në çdo çështje që ndikon në jetën e tyre; që ata janë të aftë të bëjnë zgjedhje dhe të marrin vendimet e tyre.

Në rastet kur personat përgjegjës duhet të marrin vendime për fëmijët dhe të rriturit vulnerabël për t'i mbrojtur ata nga rreziqet, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë fokusi i vendimmarrjes. SHMFF është e angazhuar të dëgjojë dhe të veprojë sipas dëshirës dhe interesit më të lartë së fëmijës, ashtu siç edhe shpjegohet në ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Të gjithë fëmijët dhe të rriturit, pa përjashtim, kanë të drejtë të jenë të mbrojtur ndaj çdo lloj forme e dhunës dhe t'u respektohet dinjiteti i tyre.

Çdo lloj forme dhune ndaj/midis fëmijëve dhe të rriturve është shkelje e të drejtave të tyre.

SHMFF Korçë ka zero-tolerancë ndaj çdo forme dhune apo shfrytëzimi ndaj fëmijëve. Kjo mbrohet përmes një pune të fuqishme parandaluese dhe përgjigjes së menjëhershme, duke ofruar mbështetje për të Projektin: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

mbijetuarit. SHMFF Korçë u siguron të gjithë aktorëve të përfshirë në menaxhimin e rastit informacionet e nevojshme për mënyrën sesi të raportojnë shqetësimet apo dyshimet e tyre mbi rastet e dhunës dhe shfrytëzimit të fëmijëve.

Të gjithë kanë përgjegjësi në mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve në situata vulnerabël.

Kjo politikë është e detyrueshme për të gjithë ata që punojnë me dhe për SHMFF Korçë, duke përfshirë këtu: punonjësit, vullnetarët dhe partnerët. Të gjithë anëtarët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë në menaxhimin e rastit në mënyrë që të plotësojnë sa më mirë përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve në situata vulnerabël. Çdo kontrate pune, shërbimi apo vullnetarizmi me SHMFF Korçë duhet të shoqërohet me firmosjen e Politikës së Mbrojtjes.

Mbrojtja aktive brenda SHMFF promovohet duke bashkuar forcat në mënyrë që fëmijët dhe të rriturit në situata vulnerabël të mbrohen në mënyrë efektive.

Mbrojtja e çdo individi është prioritet për SHMFF. Situatat e dhunës dhe llojeve të ndryshme të abuzimeve ndaj fëmijës mund të shtohen, sidomos kur stafi, vullnetarët, partnerët, vetë fëmijët, familjet apo pjestarë të komunitetit nuk janë në gjendje të shprehin shqetësimet e tyre. Në këtë shërbim promovohet dhe theksohet rëndësia e qasjes pozitive të ndërveprimit me njëri-tjetrin, bëhen përpjekje që të sigurohet një mjedis i sigurt (në qendër, komunitet, familje) i cili lejon zhvillimin pozitiv të fëmijës dhe të rriturve, duke marrë në konsideratë specifikat e situatës në të cilën gjenden ata.

Çdo raportim shqetësues në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e një fëmije do të ndiqet me prioritet. Për çdo raportim, merren hapat e nevojshëm dhe të përshtatshëm për të mbrojtur fëmijën dhe ndërmerren masat e duhura ndaj abuzuesit. Këtu përfshihet : referim i rastit tek strukturat ligjore dhe Strukturat e Mbrojtjes së Fëmijëve. Në rastet e dyshimeve/akuzave ndaj stafit, vullnetarëve apo partnerëve, mund dhe merren masa të tilla si pezullim nga detyra apo shkëputje të përhershme të çdo marrëdhënieje pune. SHMFF Korçë ka detyrim të reagojë ndaj çdo lloj forme të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit pavarësisht nëse është e dyshuar, në tentativë apo e kryer. Këto reagime do të jenë gjithmonë në përputhje me natyrën e rastit dhe duke patur në vëmendje të plotë kujdesin dhe ruajtjen e konfidencialitetit të plotë.

Konfidencialiteti

SHMFF Korçë ka në fokus të veçantë ruajtjen e konfidencialitetit në ndarjen e informacioneve të ndjeshme në lidhje me historikun dhe nevojat e fëmijëve që ka në menaxhim dhe jo vetëm.

Informacionet identifikuese do të ndahen vetëm kur rrezikohet siguria dhe mirëqënia e fëmijës apo individëve të tjerë të përfshirë në procesin e menaxhimit.

Angazhimi për praktika të mira

SHMFF Korçë synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të influencojë të tjerët për rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rriturve në situata vulnerabël përmes politikave dhe procedurave të ndjekura si një mënyrë për të theksuar angazhimin tonë dhe gjithashtu për të shpjeguar vlerat tona. Nuk ka një mënyrë specifike e cila duhet ndjekur për të siguruar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve apo të rriturve të cilët gjenden në situata vulnerabël. Zgjidhjet e ndryshme për sa i përket këtyre target grupeve, duhet të kenë në fokus kulturën dhe mjedisin në të cilin ndodhet rasti dhe natyrën e aktiviteteve që do të

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



ndërmerren. Aty ku është e mundur, kërkohet mendimi i fëmijës dhe të rriturve për t'u përdorur më pas si një guidë për hartimin, implementimin dhe rishikimin e Politikës së Mbrojtjes. Kjo politikë duhet të jetë një instrument që njihet dhe kuptohet edhe nga vetë fëmijët.

Politikat

SHMFF Korçë ka zhvilluar këtë politikë si një deklaratë të qëllimit për ruajtjen e mirëqenies së fëmijëve dhe të rriturve në situata vulnerabël të cilat janë në proces menaxhimi. Synohet që kjo politikë të përdoret brenda shërbimit për qëllime komunikimi dhe trajnimi, edhe së jashtmi, për informim dhe të të arritur një të kuptuar të përbashkët.

Politika e Mbrojtjes së SHMFF synon të:

- sigurojë që Bashkia merr përsipër përgjegjësitë e saj në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve duke iu përgjigjur shqetësimeve në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë;
- sigurojë udhëzime për punonjësit dhe të përcaktojë pritshmëritë në punën e parandalimit, raportimit dhe përgjigjes ndaj rasteve të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit;
- zvogëlojë rrezikun e dëmtimit dhe abuzimit përmes rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësve dhe vullnetarëve të shërbimit;
- referojë dhe raportojë rastet tek autoritetet përkatëse atëherë kur është e nevojshme;
- zvogëlojë rrezikun e dëmtimit dhe abuzimit duke zhvilluar një kulturë/qasje të hapur dhe të vetëdijshme të menaxhimit brenda shërbimit;
- promovojë një praktikë të mirë pune duke u siguruar fëmijëve sigurinë e duhur, ndërsa janë nën kujdesin e SHMFF Korçë dhe të lejojë stafin të ndër marrë hapat e duhur dhe të nevojshëm për çështje specifike të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rriturve të cilët gjenden në situata vulnerabël.

Politika e Mbrojtjes së SHMFF Korçë shpjegon:

- SHMFF Korçë është e vendosur të promovojë të drejtat e fëmijës dhe të rriturve në shërbimet, programet dhe aktivitetet e saj dhe rrjedhimisht është e vendosur të luftojë dhunën dhe abuzimin si një çështje kryesore;
- Të gjithë punonjësit e SHMFF Korçë janë të qartë për rolet dhe përgjegjësitë e tyre në parandalimin e dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit;
- Të gjithë punonjësit e SHMFF Korçë janë të qartë se si të presin, si t'u përgjigjen dhe si të raportojnë shqetësimet ndaj rasteve të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit.

Implementimi i Politikës dhe Procedurat

Parandalimi është një ndër shtyllat kryesore të Politikës së Mbrojtjes. SHMFF Korçë është e angazhuar të parandalojë dëmtimin e fëmijëve dhe të rriturve vulnerabël përmes fushave të mëposhtme:

1. Vlerësimi i Rrezikut dhe Menaxhimi

Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

SHMFF Korçë është e angazhuar për një qasje sistematike të vlerësimit të rrezikut, me fokus në promovimin e mirëqenies së gjithë fëmijëve, të rriturve, familjeve, stafit, partnerëve dhe vizitorëve, përmes identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve kryesore.

Qëllimi i këtij vlerësimi dhe menaxhimi gjithëpërfshirës të rrezikut është të sigurojë që janë ndërmarrë vlerësime të përshtatshme dhe të mjaftueshme për aktivitetet ku ka gjasa të ketë rrezik të konsiderueshëm. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet fushave kryesore të rrezikut siç janë programet e SHMFF-së që lidhen me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël dhe shërbimet e ofruara.

Vlerësimet e rrezikut do të marrin në konsideratë:

- a) Rreziqet - identifikimin e diçkaje që ka potencial të shkaktojë dëm
- b) Rreziqet - një vlerësim i gjasave që rreziqet të që shkaktojnë dëm
- c) Vlerësimi i rrezikut - një vlerësim i ashpërsisë së rrezikut në një situatë
- d) Masat e kontrollit - identifikimi i masave dhe procedurave fizike, të cilat mund të ndërmerren për të zbutur rrezikun.

Duke patur parasysh formatin e mësipërm, procesi i vlerësimit të rrezikut do të konsistojë në gjashtë hapa të cilët përcaktojnë:

- a) Cfarë mund të mos funksionojë?
- b) Kush mund të dëmtohet?
- c) Sa gjasa ka që të mos funksionojë?
- d) Sa serioze do të ishte situata nëse nuk do të funksiononte?
- e) Cfarë mund të bëhet për te parandaluar keqfunksionimin?
- f) Si do të kontrollohet nëse plani është apo jo funksional?

Ky proces duhet të përfundohet përmes plotësimit dhe rregjistrimit të një formulari të vlerësimit të rrezikut (modeli i të cilit jepet në Shtojcën 6), nga anëtari i stafit që organizon aktivitetin. Kjo formë e Vlerësimit të Rrezikut duhet të paraqitet për aprovim në pikën qendrore përkatëse të kësaj Politike Mbrojtëse.

2. Rekrutimi i Sigurt për Fëmijët

SHMFF KORÇË pranon që krijimi i mjediseve të sigurta për fëmijët dhe të rriturit vulnerabël fillon me emërimin e personelit të kualifikuar, të aftë dhe të verifikuar, i cili ka aftësitë dhe cilësitë e dëshiruara për të kryer funksionin në mënyrë efektive, eficiente dhe të sigurtë. Prosesi i rekrutimit brenda SHMFF bëhet në përputhje me interesat më të lartë të fëmijëve dhe të rriturve vulnerabël, duke reflektuar angazhimin e SHMFF në mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e dhunës në të gjitha format.

Rekrutimi i stafit

Përveç proceseve standarde të rekrutimit të SHMFF KORÇË dhe Bashkisë Korçë, zbatohen gjithashtu masat e mëposhtme të mbrojtjes:

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (*Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror*)



BASHKIA KORÇË

- Reklamata e rekrutimit ose detajet e aplikimit duhet të deklarohen që rekrutimi është bërë në përputhje me praktikën e sigurta të rekrutimit.
- Përkufizimi i qartë i përshkrimeve të punës dhe roleve duke iu referuar përgjegjësi mbrojtëse dhe specifikimeve të qarta të roleve që përmbajnë kompetencat thelbësore në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve vulnerabël.
- Një proces formal i përzgjedhjes së një liste të shkurtër aplikantësh, që duhet të bazohet në një set kriteresh të vendosura në përputhje me specifikimet e punës/rolit të punës, kualifikimet e kërkuara dhe parimet e politikës së mbrojtjes.
- Intervistat bëhen sipas parimeve të mundësive të barabarta dhe pyetjet e intervistave bazohen në përshkrimin përkatës të punës dhe specifikimet përkatëse.
- Ofertat zyrtare të punës bëhen pas kontrolleve për përshtatshmëri në lidhje me këtë politikë dhe në lidhje me specifikat e punës. Prandaj, çdo dokument në lidhje me shëndetin, arsimin dhe në përgjithësi çdo informacion tjetër që mund të kërkohej, është absolutisht i nevojshëm për një qëllim të caktuar, përdorimi i tij do të kufizohet rreptësisht brenda këtij qëllimi dhe është në përputhje me parimet legjislative të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave.
- Të gjithë aplikantëve do t'u kërkohej t'i nënshtrohen proceseve përkatëse të verifikimit (të cilat mund të përfshijnë kontrolle të dëshmi të penaltetit, subjekt i juridiksioneve vendore). Që prej fillimit të punësimit dhe nënshkrimit të kontratës së punës mes punonjësit dhe SHMFF KORÇË, do të nënshkruhet gjithashtu edhe një deklaratë ku pohohet se nuk ka asnjë arsye ose ngjarje (dënime penal ose ndjekje penale në vazhdim kundër tyre) që do t'i bënte ata (punonjësit) të papërshtatshëm për vendin e punës (shih Shtojcën 5 si shembull).
- Nga aplikantët do të kërkohej që të paraqesin gjithashtu dy emra të cilëve do t'u kërkohej të japin referenca për aplikantin, duke përfshirë këtu pikëpamjen e referuesit për përshtatshmërinë e kandidatit për të qenë në kontakt me fëmijët dhe të rriturit. Struktura kontraktuese si Bashkia dhe SHMFF KORÇË ka të drejtën të kontaktojë referuesit.
- Aplikantit të përzgjedhur do t'i ofrohet një pozicion pune në përputhje me: (a) referencat e përshtatshme; (b) dëshminë e kualifikimeve; (c) procedurat përkatëse të verifikimit.;

Përzgjedhja e konsulentëve për të punuar me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël

Të gjithë konsulentëve ose kontraktorëve të tjerë të identifikuar që janë aktualisht “duke punuar me fëmijë dhe të rriturit vulnerabël” do t'u kërkohej t'i nënshtrohen proceseve përkatëse të verifikimit (të cilat mund të përfshijnë kontrolle të dëshmi të penaltetit, subjekt i juridiksioneve vendore). Ai/ajo do të nënshkruajë një deklaratë ku thuhet se nuk ka asnjë arsye ose ngjarje (dënime penal ose ndjekje penale në vijim kundër tyre) që do t'i bënte ata të papërshtatshëm për pozicionin e punës.

3. Vullnetarët dhe vizitorët

Ky seksion në mënyrë specifike shqyrton çështjet e mbrojtjes në lidhje me llojet e ndryshme të mbështetjes vullnetare për aktivitetet e SHMFF KORÇË ose vizitorëve të programeve dhe shërbimeve të SHMFF-së.

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

- Vizitorët zyrtarë mund të vizitojnë një projekt me lejen e SHMFF KORÇË dhe Drejtorisë së Kujdesit Social në Bashkinë Korçë;
- Të gjithë vizitorët/vullnetarët duhet të kontaktojnë me personin përgjegjës në SHMFF gjatë mbërritjes duhet të nënshkruajnë Deklaratën e Vizitorit (shtojca 7);
- Është përgjegjësi e anëtarit të stafit të sigurojë që vizitorët dhe vullnetarët janë të informuar në mënyrë të përshtatshme dhe të supervizuar si duhet gjatë gjithë aktivitetëve ose vizitave;
- Të gjithë vullnetarët dhe vizitorët e rastit duhet të shoqërohen në çdo kohë dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të lihen të pasupervizuar me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël;
- Të gjithë anëtarët e stafit dhe vullnetarët e rregullt do t'u kërkohet të paraqesin të gjitha dëshmitë e përmendura në pikën 2- Rekrutimi i Sigurt. Kjo bëhet me qëllim që të parandalohen persona të papërshtatshëm të punojnë me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël.

Rekrutimi i vullnetarëve: Nëse përgjegjësitë e rëna dakord përfshijnë kontakte me fëmijët apo të rriturit, procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes nuk ndryshon nga qasja e përdorur për të punësuar punonjës të përhershëm ose konsulentë.

Në rast se ata nuk pranojnë të angazhohen ose nuk respektojnë angazhimin e tyre të deklaruar me shkrim për të respektuar politikën aktuale dhe kodin e detyrueshëm të sjelljes, vullnetarizmi i tyre do të përfundojë dhe / ose vizita do të përfundojë.

4. Kodi i sjelljes

Të gjithë ata që ndjekin këtë politikë angazhohen për të respektuar, promovuar, mbështetur dhe mbrojtur në çdo kohë të drejtat e fëmijës siç përcaktohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Standardet e sjelljes të përcaktuara nga Kodi (shiko më poshtë) kërkohen nga të gjithë ata që ndjekin këtë politikë në lidhje me sjelljen e tyre ndaj të gjithë fëmijëve. Respektimi i këtyre standardeve do të interpretohet brenda kornizës së Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Kushdo që konstatohet se është në shkelje të Kodit do t'i nënshtrohet masave disiplinore, duke përfshirë largimin nga detyra, përfundimin e punës dhe/ose marrëveshjeve të tjetra me SHMFF.

- Gjithmonë trajtojeni fëmijët dhe të rriturit me respekt, pavarësisht gjinisë apo identitetit gjinor, origjinës, etnisë, gjuhës, besimeve fetare ose besimeve të tjera, nevojave të veçanta, orientimit seksual dhe/apo statusit.
- Përdorni gjuhë dhe sjellje ndaj fëmijëve dhe të rriturve që është gjatë gjithë kohës e përshtatshme dhe në asnjë mënyrë ngacmuese, abuzive, seksuale ose poshtëruese.
- Ndalohet përdorimi i papërshtatshëm i çdo kompjuteri, telefoni celular, video / aparati dixhital ose pajisjeve të tjera elektronike, përfshirë hyrjen, shikimin, krijimin, shkarkimin ose shpërndarjen e imazheve të abuzimit seksual në internet të fëmijëve.
- Ndalohet ndëshkimi fizik ose përdorimi i forcës së papërshtatshme fizike të çfarëdo lloji ndaj fëmijëve.
- Ndalohet përdorimi i fëmijëve për punë shtëpiake ose punë tjetër kur: është puna është e papërshtatshme për moshën ose aftësitë zhvillimore të fëmijës; ndërhyr në kohën e e posaçme për edukim dhe aktivitete krijuese; e vendos atë në rrezik të konsiderueshëm dëmtimi, shfrytëzimi dhe/ose abuzimi.

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

- Raportoni menjëherë çdo shqetësim, dyshim, incident ose pretendim të abuzimit aktual ose të mundshëm të fëmijëve ose ndonjë shkelje të kësaj politike në përputhje me Procedurat e duhura dhe tek personi i përgjegjës (shih më poshtë), i ngarkuar për marrjen e ankesave të tilla. Personi që bën një raport me mirëbesim nuk do t'i nënshtrohet shpagimit/hakmarrjes. Një person mund të raportojë mbi baza anonime; megjithëse kjo mund të pengojë aftësinë e Zyrtarit të Caktuar për të hetuar plotësisht pretendimet.
- Aktiviteti seksual me fëmijë apo me të rritur është i ndaluar pavarësisht nga mosha e individit dhe/ose pëlqimit që ai/ajo jep. Pretendimi për bësime të caktuara lidhur me moshën e fëmijës nuk është argument për mbrojtje.
- Shfrytëzimi seksual dhe abuzimi nga punonjësit e SHMFF përbëjnë akte të sjelljes së rëndë dhe rrjedhimisht janë arsye për ndërprerjen e punës dhe referimin tek strukturat përkatëse për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.
- Ndalohet shkëmbimi i parave, punësimit, mallrave ose shërbimeve seksuale, duke përfshirë favore seksuale ose forma të tjera të sjelljes poshtëruese, degraduese ose shfrytëzuese.
- Ndalohet çdo marrëdhënie seksuale midis atyre që ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje dhe një personi që e përfiton atë. Kjo përfshin përdorimin dhe shfrytëzimin e padrejtë të përfituesit. Marrëdhënie të tilla dëmtojnë besueshmërinë dhe integritetin e punës për ofrimin e këtij shërbimit dhe qëllimeve të tij.
- Punonjësit e SHMFF janë të detyruar të krijojnë dhe mbajnë një mjedis i cili parandalon shfrytëzimin seksual dhe abuzimin, dhe në të njëjtën kohë promovon zbatimin e kodit të sjelljes. Punonjësit në të gjitha nivelet kanë përgjegjësi të veçanta për të mbështetur dhe zhvilluar sisteme të cilat mbajnë këtë mjedis të sigurtë.
- Sjelljet personale jashtë punës që shihet se bien në kundërshtim me këtë politikë do të konsiderohen shkelje të politikës. Nga punonjësit e SHMFF KORÇË kërkohet që t'u përmbahen parimeve të politikës së mbrojtjes së fëmijës dhe të rriturve si në punë ashtu edhe jashtë punës. Ndjesia e bashkësisë do të mbizotërojë në zbatimin e kësaj politike në jetën private të stafit.

5. Edukimi, Trajnimi dhe Mbështetja

Ndërgjegjësimi dhe trajnimi

SHMFF KORÇË kupton se në mënyrë që politika të kuptohet mirë dhe të implementohet në mënyrë efektive, është thelbësore që të ketë nivele të larta të ndërgjegjësimit dhe njohurive në lidhje me këtë politikë dhe që stafi dhe të tjerët të jenë të qartë, të sigurtë dhe kompetentë në zbatimin e politikës në praktikë.

SHMFF angazhohet të:

- Shpërndajë dhe promovojë politikën në disa mënyra (p.sh., ëëb, të printuar dhe verbalisht). Kopjet e politikës do të bëhen të disponueshme dhe të arritshme për të gjithë palët e interesuara, si në kopje fizike edhe në kopje elektronike.
- Informimet dhe trajnimet e rregullta do të sigurohen si pjesë e zbatimit të politikës dhe këto, ose elementë të tyre, do të përfshihen në proceset standarde për të gjithë stafin. Trajnimi mbi politikën do të jetë i detyrueshëm dhe do të kryhet çdo vit. Personeli i sapo rekrutuar do të marrë sesione hyrëse dhe do të marrë pjesë në trajnimin tjetër të ardhshëm. Përgjegjësi i SHMFF-së i

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

shërbimit do të vendosë për kohën, varësisht nga roli që ka anëtari i stafit brenda SHMFF, por në çdo rast do të jetë brenda 3 muajve nga fillimi i punësimit ose para se të mbarojë periudha e provës.

- SHMFF KORÇË do të sigurojë akses në ndryshimet/përditësimet e trajnimeve për të siguruar që politika vazhdon të jetë pjesë e secilit dhe që stafi të ndërgjegjësohet për ndryshimet dhe zhvillimet në politikë dhe zbatimin e saj.
- SHMFF KORÇË do të sigurojë trajnime të mëtejshme për stafin me përgjegjësi specifike sipas kësaj politike. Këto grupe do të përfshijnë çdo person që punon drejtpërdrejtë me fëmijët dhe punonjësën e caktuar. Trajnimi i ofruar për koordinatorin dhe stafin është i dizenuar për marrjen e njohurive mbi procesin e marrjes dhe përgjigjes së ankesave dhe incidenteve të mbrojtjes.
- SHMFF KORÇË do t'i sigurojë stafit akses në materiale dhe burime që mbështesin të kuptuarit dhe zbatimin e politikës.

6. Komunikimi Child-Safe

Përdorimi publik i imazheve dhe historive të fëmijëve dhe të rriturve mund të paraqesë rreziqe të cilat cënojnë sigurinë dhe mbrojtjen e tyre. Prandaj është e rëndësishme të konsideroni interesin më të lartë të fëmijës dhe të të rriturit kur përdorni imazhet dhe historitë e tyre. Kjo përfshin respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të tyre, përfshirë këtu të drejtën për privatësi dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Pëlqimi duhet të merret gjithmonë para se të bëni foto të fëmijëve dhe të rriturve vulnerabël. Stafi i SHMFF KORÇË duhet të sigurojë që:

- çdo imazh i marrë nga stafi ka marrë pëlqimin me shkrim ose verbal të fëmijëve dhe/ose kujdestarëve të tyre dhe të rriturve vulnerabël;
- imazhet ose historitë nuk zbulojnë identitetin ose vendndodhjen e fëmijës dhe të rriturve;
- është bërë kujdes për të ruajtur identitetin e fëmijëve dhe të rriturve vulnerabël;
- imazhet që tregojnë fëmijët dhe të rriturit që janë marrë gjatë vizitave në vende të ndryshme nuk përdoren në llogaritë personale në mediat sociale të stafit të SHMFF Korçë.

7. Krijimi i programeve dhe Implementimi i tyre

Programet dhe të gjitha llojet e veprimeve në të gjithë sektorët që SHMFF mbulon, jo vetëm në programet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rriturve, duhet të garantojnë në çdo kohë dhe në të gjitha aktivitetet mbrojtjen e individëve. Pra, punonjësit e këtij shërbimit nuk duhet të të konsiderojnë mbrojtjen si një aktivitet të veçantë, por përkundrazi, duhet të jetë një çështje e integruar kudo dhe në çdo kohë.

- Mbrojtja duhet të konsiderohet në çdo fazë, nga hartimi i projektit / programit dhe duhet të rishikohet rregullisht si pjesë e monitorimit të zbatimit të projektit.
- Përveç hartimit të programit, gjatë kryerjes së aktiviteteve specifike, siç mund të jenë konsultimet me fëmijë dhe të rriturit, ose gjatë aktiviteteve të tjera, duhet të vlerësohen rreziqet në mënyrë që të identifikohen ato dhe të hartohet një plan i mundshëm për minimizimin e tyre.
- Nëse është e nevojshme, stafit, vullnetarëve, partnerëve, fëmijëve dhe komuniteteve duhet t'u jepen udhëzime shtesë në mënyrë që të sigurohet që fryma e Politikës së Mbrojtjes është

Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

prezente në aktivitete ose programe specifike, për shembull për të nxjerrë në pah rreziqe ose shqetësime të veçanta.

- Para se të zhvillohen aktivitetet, duhet të merret leja me shkrim si e prindërve, ashtu edhe e fëmijëve/të rriturve. (Shih Shtojcën 3 - Formulari i Pëlqimit Prindëror). Kur prindërit / fëmijët/të rriturit janë analfabetë, një anëtar i stafit ose një vullnetar mund të nënshkruajë në emër të tyre në prani të tyre, për sa kohë që formulari është diskutuar dhe dakordësuar me individin.
- Personeli dhe vullnetarët që punojnë me fëmijët duhet të mbikqyren rregullisht dhe t'u jepet mundësia të marrin pjesë në diskutime rreth çështjeve të mbrojtjes - për shembull në takime, diskutime joformale ose në diskutime për studime të rasteve.
- Mbrojtja duhet të rishikohet rregullisht gjatë aktiviteteve dhe në fund të aktiviteteve, në mënyrë që mësimet e marra të bëhen pjesë e aktiviteteve të ardhshme ose të bëhen rregullimet e nevojshme ndërsa programi vazhdon. Për shembull, gjatë një programi aktiviteteesh verore do të ishte e dobishme në fund të çdo dite të përfshihet një rishikim i mbrojtjes gjatë takimeve të përmbledhjes.

8. Raportimi dhe Përgjegjja ndaj shqetësimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve

SHMFF KORÇË është e angazhuar t'u përgjigjet të gjitha raportimeve apo indikacioneve, përfshirë thashethemet, që sugjerojnë se një fëmijë mund të jetë dëmtuar ose rrezikon të dëmtohet. Siguria e fëmijëve duhet të jetë shqetësimi kryesor në çdo kohë. Përgjegjësi i SHMFF, është përgjegjës për të siguruar që procedura e raportimit e përshkruar më poshtë të ndiqet; kjo pasi është e domosdoshme që rastet e dyshuara të abuzimit dhe / ose shkeljet e Politikës së Mbrojtjes nga stafi i SHMFF KORÇË, të marrin përgjigje në mënyrë të përshtatshme dhe të referohen menjëherë tek autoritetet përkatëse siç kërkohet.

Përgjegjësi i SHMFF

Përgjegjësi i SHMFF është pika qendrore për raportimin dhe referimin e shqetësimeve në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, për koordinimin e ndërhyrjeve të nevojshme dhe ndjekjen e tyre. Për qëllimet e procedurave të mbrojtjes, funksionet e përgjegjësimit do të kryhen nga vetë ai/ajo. Sidoqoftë, kur Përgjegjësi i SHMFF nuk mund të përgjigjet brenda afateve të përcaktuara kohore, veprimi duhet të ndërmerret nga kushdo që është nominuar për të kryer rolin e tij/saj në mungesë. Çdo emërim i përkohshëm do të bëhet nga Drejtori i Kujdesit Social dhe do t'i komunikohet të gjithë stafit. Roli i Përgjegjësimit do t'i delegohet vetëm një anëtar i stafit i cili ka njohuritë, aftësitë dhe trajnimin e nevojshëm për të ndërmarrë këtë rol. Kur një delegim i tillë është i nevojshëm, emërimi do të komunikohet zyrtarisht nga Drejtori i Kujdesit Social.

Përgjegjësi i SHMFF është përgjegjës për:

- Sigurimin e një kopje me shkrim të çdo referimi zyrtar tek Drejtori i Kujdesit Social brenda 24 orëve. Një linjë raportimi nga Përgjegjësi tek Drejtori i Kujdesit Social siguron që të gjitha vendimet të konsultohen, sikurse siguron që me njohurinë dhe aprovimin e Drejtorit të Kujdesit Social, SHMFF të marrë përgjegjësitë përkatëse;

Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

- Hapi i parë i çdo incidenti të raportuar është garantimi i sigurisë së fëmijëve/ të rriturve në fjalë;
- Të gjitha raportimet dhe shqetësimet duhet të rregjistrohen duke përdorur formularin në Shtojcën 1 (Formati i raportimit dhe regjistrimit të politikës së mbrojtjes);
- Sigurimin që të dhënat me shkrim të shqetësimeve për një fëmijë/të rritur të mbahen edhe nëse nuk është i nevojshëm referimi i menjëhershëm;
- Sigurimin që të gjitha të dhënat e tilla ruhen në mënyrë konfidenciale dhe janë të ndara nga shkresat / të dhënat e çështjes, me një fletë të përparme duke renditur datat dhe shënimet e shkurtra për të siguruar një kronologji të ngjarjes/ve;
- Sigurimin që çdo shënim i të dhënave të mëtejshme lidhur me mbrojtjen e fëmijëve është shënuar në dosjen e rastit;
- Vepron si një pikë qendrore për stafin për të diskutuar shqetësimet dhe komunikon me agjenci/struktura dhe profesionistë të tjerë;
- Pjesëmarrja në konferenca për mbrojtjen e fëmijëve (ose delegimi i kësaj kërkesë një anëtar tjetër të stafit të informuar në mënyrë të përshtatshme);
- E mban veten të hapur ndaj njohurive të reja për t'u aftësuar në përmbushjen e rolit, përfshirë ndjekjen e trajnimeve përkatëse;
- Jep këshilla dhe udhëzime për kolegët, pjesëmarrja në takime me agjenci/struktura/shoqata të ndryshme (ose mbështetja e stafit tjetër për ta bërë këtë) dhe kontribuon në vlerësime.

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



Raportimi dhe procedurat e referimit

Çfarë duhet bërë kur ke shqetësime për sigurinë e fëmijës dhe të rriturit vulnerabël:

- një fëmijë/i rritur të afrohet dhe në konfidencialitet të thotë se ai/ajo është dëmtuar, dhunuar ose neglizhuar;
- njoftohesh për këtë rast konfidencial nga një pjestar i stafit, vullnetar apo një person tjetër që ka qenë në kontakt me fëmijën/të rriturin;
- Ti je i shqetësuar se fëmija/l rrituri mund të ketë përjetuar lëndim apo dhunë

Përgatit një raport të shkruar duke përfshirë informacionin/vëzhgimin e bërë dhe përfshi kohën, datën dhe personat prezent si më poshtë:

- Hetim i Përgjithshëm (Si të mbrojmë fëmijët) - Përgjigje brenda 24 orësh;
- Jo specifike / Pretendime/ akuza të paqarta (pa emra / tipare identifikuese) - Përgjigje brenda 72 orësh;
- Specifike – emra/ vendet e përmendura & raportimi - Vendimi fillestar për veprim brenda 48 orësh;
- E rëndësishme – përfshirja e stafit të SHMFF, drejtorit të kujdesit social në Bashki, vullnetarëve, dhe njerëzve të tjerë të rëndësishëm në proces – vendimi fillestar mbi veprimin brenda 24 orëve.

Përgatit një raport të shkruar duke përfshirë informacionin dhe vëzhgimin e kryer dhe përfshi kohën, datën dhe personat present.

Informoni menaxherin tuaj brenda afatit kohor të lartpërmendur.

Ekipi i SHMFF do të vlerësojë incidentin dhe / ose do ta referojë rastin tek Përgjegjësi i SHMFF.

Kur Përgjegjësi i SHMFF nuk është në gjendje të përgjigjet brenda afateve të përcaktuara, veprimet duhet të ndërmerren nga kushdo që është emëruar

përkohësisht për të kryer rolin e Përgjegjësit të SHMFF.

Nëse menaxheri i rastit nuk është i disponueshëm, kontakto Përgjegjësin e SHMFF.

A ka fëmija/l rrituri nevojë për ndërhyrje urgjente mjekësore ose policore?

Jo – Kontaktoni menjëherë shërbimet e urgjencës. Qëndroni me fëmijën/të rriturin derisa shërbimet e urgjencës të marrin përsipër çështjen, kontaktoni Përgjegjësin e SHMFF dhe plotësoni formularin.

Jo – Kontaktoni Përgjegjësin e SHMFF

Çfarë duhet bërë në raste akuzash ndaj stafit ose të tjerëve:

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Ti je i shqetësuar se sjellja e një pjestari të stafit apo një personi tjetër është kërcënuese/ potencialisht kërcënuese për mirëqenien e fëmijës/të rriturit

Raporto shqetësimet menjëherë tek Përgjegjësi i SHMFF.
Ku është e përshtatshme, trajtim sipas nevojës mund të fillohet dhe/ose referim tek një agjensi tjetër e jashtme.

Në të gjitha situatat, duhet të paraqisni një përmbledhje të shqetësimeve tuaja me shkrim. Nëse çështja u referohet agjencive të jashtme ose policisë, mund t'ju kërkohet të jepni një deklaratë zyrtare të shqetësimeve tuaja për hetimet e mëvonshme.

Në mungesë të personit që ka autorizim për të marrë vendime, nëse një fëmijë/i rritur është në një situatë të rrezikshme për jetën, personi me më shumë eksperiencë pune ka autorizimin për të marrë vendimin e nevojshëm për të mbrojtur fëmijën/të rriturin nga rreziku i menjëhershëm. Çdo vendim i marrë dhe veprimet e ndërmarra duhet të raportohen tek përgjegjësi i SHMFF dhe Drejtori i Kujdesit Social në Bashkinë Korçë.

Kujdes: Nëse keni shqetësime se një fëmijë apo i rritur vulnerabël është në rrezik real dhe sinjifikant kontakto Përgjegjësin e SHMFF ose Drejtorin e Kujdesit Social në Bashkinë Korçë. Nëse mendoni se është kryer shkelje ligjore kontakto Policinë.

Menaxhimi i Politikave

1. Rolet dhe Përgjegjësitë

I gjithë stafi (stafi i brendshëm, partnerët, vullnetarët) orientohen nga parimet dhe udhëzimet e përcaktuara në këtë politikë dhe politikat e tjera të SHMFF. Më specifikkisht, stafi në bazë të kontekstit të çdo pozicioni pune pritet që:

- të ndjekë procedurat e kërkuara;
- të promovojë një praktikë të mirë pune dhe të kontribuojë në diskutimet mbi mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve/të rriturve në situata vulnerabël;
- të sigurojë që zëri i fëmijëve/të rriturve dëgjohet në çdo kohë dhe situatë;
- të respektojë kufijtë profesionalë dhe kodin profesional të sjelljes të përmendura në këtë dokument. Anëtarët e SHMFF Korçë janë të detyruar të ndjekin këtë politikë dhe kanë përgjegjësitë shtesë:

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

- të monitorojnë dhe rishikojnë politikën;
- sigurojnë që i gjithë stafi ka akses në trajnimet/informacionet e nevojshme;
- të sigurojnë që burimet e mjaftueshme (kohë dhe para) janë alokuar duke bërë të mundur implementimin efektiv të shërbimeve;
- të dëgjojnë shqetësimet e stafit dhe përfituesve (fëmijë dhe të rritur) mbi politikën e mbrojtjes dhe tu përgjigjet këtyre shqetësimeve në mënyrë serioze, të përshtatshme dhe sa më shpejt të jetë e mundur;
- të jetë koherent me çështjet/aktivitetet lokale, të zhvillojë dhe mbajë lidhje efektive me agjenci/shoqata të ndryshme;
- të ketë përgjegjësinë finale për zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e politikës aktuale.

Stafi ka përgjegjësinë të jetë vigjilent, të ketë njohuri dhe të jetë i ndërgjegjshëm mbi indikatorët e dëmtimit, neglizhimit, dhunës potenciale apo asaj aktuale dhe gjithashtu duhet të raportojë çdo shqetësim, dyshim apo pretendim mbi çdo lloj forme dhune të dyshuar. Çdo shqetësim duhet të merret seriozisht dhe duhet raportuar.

2. Monitorimi i Politikës

- Procedurat e rekrutimit dhe selektimit duhet të përmirësohen/rifreskohen në mënyrë të vazhdueshme;
- Informimet zyrtare dhe ndërgjegjësimi do të synojnë të gjithë punonjësit dhe të tjerët;
- Do të realizohet një vlerësim për rrezikun në përputhje me nivelin e kontaktit me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël;
- Përgjegjësi i SHMFF do të jetë përgjegjës për zbatimin e politikës;
- Raportimi i shqetësimeve mbi dhunën ndaj fëmijëve/të rriturve vulnerabël do të jetë e detyrueshme për të gjithë punonjësit dhe të tjerët;
- Do të zhvillohen procedurat të mëtejshme lokale për ndërgjegjësimin dhe raportimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe të rriturve në situata vulnerabël.

3. Komunikimi dhe Angazhimi ndaj Politikës

SHMFF Korçë do të informojë të gjithë përfituesit e shërbimeve mbi Politikën e Mbrojtjes, duke përdorur mjetet dhe komunikimin e duhur që është në përputhje me moshën dhe profilin e çdo përfituesi, duke u siguruar kështu që parimet dhe procedurat e politikës janë kuptuar siç duhet. Këto mënyra përfshijnë:

- Paketë informacioni lehtësisht e kuptueshme dhe gjithëpërfshirëse mbi politikën, p.sh. përmes broshurave, dokumenteve, informacionit të shfaqur në internet, etj;
- Një version miqësor për fëmijët i politikës së mbrojtjes për fëmijët është përgatitur dhe në dispozicion për fëmijët pranë çdo ambjenti të qendrës.

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

- Diskutim dhe marrëveshje me çdo përfitues mbi politikën dhe procedurat e ankesave/shqetësimeve.

Çdo person si sponsorët, vullnetarët, kontraktuesit, donatorët, gazetarët, konsulentët, mbështetësit të cilët vizitojnë zyrat e SHMFF Korçë dhe që mund të jenë në kontakt apo ndërveprojnë me fëmijët dhe të rriturit:

- u jepet një kopje e Politikës së Mbrojtjes dhe u bëhet me dije që duhet të veprojnë në përputhje me të gjatë kohës që janë në ambientet e SHMFF Korçë;
- deklarojnë me shkrim angazhimin e tyre për të respektuar dhe për të vepruar sipas parimeve të politikës;
- Informohen mbi procesin e raportimit të shqetësimeve në rastet kur dyshohet për cënim të mirëqenies së fëmijëve apo të rriturve vulnerabël;
- Parandalimi;
 - Duke rritur ndërgjegjësimin mbi dhunën ndaj fëmijëve/të rriturve dhe rreziqeve që ata hasin përmes implementimit të kësaj politike;
 - Mbrojtja;
 - Minimizimi i rreziqeve duke bërë vlerësim të rrezikut në të gjitha pozicionet ku ka kontakt/ndërveprim me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël dhe promovimi i ndërgjegjshmërisë mbi dhunën ndaj fëmijëve;
 - Mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve, punonjësve dhe të tjerëve në rastet e dyshimeve, akuzave, pretendimeve mbi dhunën ndaj fëmijëve/të rriturve;
- Rehabilitimi dhe Integrimi
 - i shqetësimeve dhe raportimi i dyshimeve, pretendimeve, akuzave të dhunës ndaj fëmijëve/të rriturve në strukturat e SHMFF Korçë dhe kur është e nevojshme tek autoritetet kompetente;
 - të diturit paraprakisht se çfarë hapash duhet të ndërmerren dhe kush duhet kontaktuar në rastet e shqetësimeve për dhunë ndaj fëmijëve dhe të rriturve;
 - mbrojtja dhe mbështetja e fëmijëve, të rriturve vulnerabël, punonjësve dhe të tjerëve përmes ndihmës psikologjike, mjekësore apo ligjore kur është e nevojshme.

4. Rishikimi i Politikës

Politika do të rishikohet çdo vit në këto rrethana:

- ndryshimet në legjislacion dhe/ose ndryshime në udhëzimet e qeverisë dhe pushtetit vendor;
- si rezultat i çdo ndryshimi të rëndësishëm apo ngjarje;

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Çdo vit, SHMFF Korçë do të kryejë një vetëvlerësim të mbrojtjes dhe zbatimit të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe përfituesve të rritur. Vlerësimi do të kryhet duke përdorur një model të caktuar. Bazuar në këtë vlerësim, do të zhvillohet një plan vjetor i veprimit për të adresuar çdo boshllëk në zbatimin e politikave dhe për të zbutur rreziqet e identifikuara.

5. Ankesat

Fëmijët/Përfituesi kanë të drejtën për ankesë formale dhe jo formale (verbal) nëse kanë një ankesë për shërbimet apo nëse mendojnë se u janë mohuar pa të drejtë shërbimet. SHMFF mund të përgatisë formularë dhe t'i vendosë në dispozicion të fëmijëve, për t'u plotësuar prej tyre në çdo moment. Pasi ta ketë mbushur formularin, përfituesi duhet t'ia japë atë një anëtar të stafit, i cili e ka për detyrë t'ia referojë koordinatorit të qendrës i cili reagon brenda 3 ditëve. Formulari mund edhe të depozitohet në kutinë e ankesave. Nëse përfituesi nuk merr një reagim në kohë, ka të drejtën të paraqesë një ankesë pranë Bashkisë. (Formular ku shpjegohet qartë procedura e ankimit, aneksi 3).

Shtojca 1: Formati i raportimit dhe regjistrimit për politikën e mbrojtjes për fëmijët dhe të rriturit

1. DETAJE TË FËMIJËS/FËMIJËVE/TË RRITURIT/TË RRITURVE

Emri:	<input type="text"/>	Gjinia: Mashkull	Femër
Mosha:	<input type="text"/>	Datëlindja:	
Adresa:	<input type="text"/>		

Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Gjuha/ët e folur/a:

Faktorë të tjerë shtesë që mund të rrisin rrezikun:

Informacione të tjera të rëndësishme:

-Emri dhe kontakte të prindërve/kujdestarëve ligjorë/kujdestarëve

Emri:

Gjinia: Maskull

Femër

Mosha:

Datelindja:

Adresa:

Gjuha/ët e folur/a:

Aftësi të kufizuar:

-Detajet e referimit

Koha:

Data:

Vendi:

Emri:

Kontakt:

Pozicioni:

Marrëdhënia me fëmijën/të rriturin:

2. DETAJE TË DHUNUESIT TË DYSHUAR/SUBJEKTIT I CILI PËRBËN SHQETËSIM PËR MBROJTJEN E FËMIJËS/ TË RRITURIT VULNERABËL

Emri:

Gjinia: Maskull

Femër

Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Shtetësia:

Mosha:

Adresa/Vendbanimi aktual:

Gjuha/ët e folur/a:

Marrëdhënia me personin e dëmtuar:

3. PËRSHKRIMI I INCIDENTIT

Çfarë ndodhi? Ju lutemi të përshkruani incidentin sa më ngjashëm të jetë e mundur me ato çfarë ju kanë thënë ose atë çfarë ju vetë keni parë? Përmendni kohën, vendndodhjen dhe individët e përfshirë/(duke përfshirë edhe vetë fjalët e fëmijës/të rriturit nëse është e mundur):

-Sigurinë aktuale të fëmijës/të rriturit, duke përfshirë dhe vendndodhjen:

-Kërkohet vëmendje emergjente mjekësore?

Siguruar nga:

-Informacione apo komente të tjera të rëndësishme?

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

-Kush tjetër është në dijeni? Përfshini detaje të kontaktit.

Agjencitë/strukturat:

Pjesëtarë të familjes ose individë të tjerë:

4. VENDIMET E MARRA DERI MË TANI (referimi në polici, në Shërbimin Social Shtetëror, Drejtorinë e Kujdesit Social; jepni detaje të kontaktit dhe ditën dhe kohën e veprimeve të ndërmarra).

5. Vendimet e marra; Rekomandime; Veprimet/hapat e marrë dhe Shtojcat (intervista, shënime)

-Personi i cili merr referimin:

Emri:

Pozicioni dhe Vendndodhja:

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Data:

Firma (e printuar në letër):

U plotësua nga:

Data:

Emri:

Firma:



Shtojca 2: Forma e miratimit të informuar për Prindin/Kujdestarin Ligjor

SHMFF Korçë është një shërbim që ekziston për të mbështetur fëmijët, të rinjtë dhe familjet dhe komunitetet në situata vulnerabël. Në kuadër të aktivitete të ndryshme që ky shërbim zhvillon mund të përfshijnë edhe fëmijën tuaj. Para fillimit të këtij bashkëpunimi, ne kemi nevojë për pëlqimin tuaj, dhe gjithashtu disa informacione të rëndësishme nga ju për të siguruar që fëmija juaj mund të marrë pjesë në këto aktivitete pa u cënuar mirëqenia apo siguria e tij. Të gjitha informacionet do të jenë konfidenciale dhe do të ndahen vetëm me të rriturit që duhet ti dinë këto informacione për të siguruar kujdesin maksimal ndaj fëmijës. Parimi ynë kryesor është që në çdo situatë, interesi më i lartë i fëmijës është fokusi ynë kryesor. Kjo do të thotë që në të gjitha veprimet dhe vendimet merren parasysh nevojat dhe të drejtat e fëmijës.

Pëlqim i informuar (Zgjidh një nga opsionet e mëposhtme):

- Unë/ne jap/im pëlqimin për/fëmijën tim/tonë (emri i fëmijës) që të marrë pjesë në aktivitetet e SHMFF Korçë.
- Unë/ne autorizoj/më stafin e SHMFF Korçë që të jetë përgjegjëse për fëmijën tim/tonë gjatë këtyre aktiviteteve dhe i autorizoj/më ata të marrin vendime në lidhje me çdo trajtim mjekësor urgjent për fëmijën tim/tonë që mund të kërkohet gjatë këtyre aktiviteteve.
- Unë/ne pohoj/më se kam autorizim të plotë për të dhënë pëlqimin tim/tonë në këtë dokument.

Pëlqimi për pjesëmarrje në aktivitete mediaktike (Ju lutemi, shënoni sipas rastit):

- Unë/ne jap/im pëlqimin për fëmijën tim/tonë për të marrë pjesë në aktivitete mediatike të cilat mund të përfshijnë fotografi, filma, kaseta video, ose forma të tjera të regjistrimit dhe që mund të shfaqen të shtypura (të tilla si gazeta) ose në internet në kuadër të promovimit të aktiviteteve të zhvilluara.
- Unë/ne NUK jap/im pëlqimin tim/tonë që fëmija im/ynë të marrë pjesë në aktivitete mediatike ose që fëmija të fotografohet gjatë pjesëmarrjes në aktivitet.
- Unë/ne konfirmoj/më që kam/kemi lexuar dhe kuptuar Formularin e miratimit të informuar dhe pajtohem që t'i përmbahemi përmbajtjes së tij.

Emri i fëmijës

Data vendi

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Emri dhe Firma (emri i prindit/prindërve)

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)

Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



Shtojca 3: Procedurat e ankimimit

Procedurat e ankimimit SHMFF

Fëmijët /përfituesit kanë të drejtë të ankohen rreth çdo aspekti të rastit të tyre dhe rreth shërbimeve që ata kanë ose nuk kanë marrë. Fëmijët mund të dorëzojnë ankesat e tyre me shkrim ose me gojë. Ata kanë gjithashtu të drejtë të ankohen edhe në mënyrë anonime. Ankesat mund t'i drejtohen stafit të SHMFF. Përveç ankimimit në mënyrë të drejtpërdrejtë verbale, përfitueset kanë në dispozicion edhe kutinë e ankimimit.

Kutia hapet nga një grup i caktuar në përbërje të të cilit është një punonjës i SHMFF, DRSHSSH, DKS, një fëmijë /përfitues, një herë në javë.

Një përshkrim i plotë i procedurës së ankesave jepet më poshtë.

Këkesa personale me gojë ose me shkrim:

- Personat të rritur apo fëmijë që marrin shërbim pranë SHMFF mund t'ia adresojë ankesën çdo anëtar i të stafit të SHMFF.
- Çdo anëtar stafi apo drejtues i ofruesit të shërbimeve që merr një ankesë me gojë ose me shkrim duhet ta regjistrojë këtë ankesë në regjistrin e ankesave, së bashku me datën e ankesës dhe mënyrën se si është adresuar ankesa.

Kërkesa formale duhet të përmbajë:

1. Natyrën e veprimit ose mosveprimit që ka çuar deri te ankesa;
2. Datën e veprimit ose mosveprimit që ka çuar deri te ankesa;
3. Palën kundër së cilës depozitohet ankesa; dhe
4. Emrin e plotë, adresën dhe numrin e telefonit të personit që ankohet.

Përdorimi i Kutisë së Ankesave:

Për të ndihmuar ata që parapëlqejnë të ankohen në mënyrë anonime ose me shkrim, është vënë në dispozicion një kuti e ankesave.

- Kutia e ankesave hapet një herë në javë nga të paktën dy anëtarë të stafit dhe në praninë e një përfituesi, fëmijë apo i rritur. Hapja e kutisë dhe shqyrtimi i ankesave nga dy anëtarë të stafit dhe përfitues, i jep më shumë legjitimitet procesit, duke siguruar më mirë që personi që hap kutinë nuk mund të vendosë në mënyrë të njëanshme që të shpërfillë një ankesë.
- Pasi të hapen dhe shqyrtohen, ankesat do të hidhen në regjistrin e ankesave, duke përfshirë datën kur është regjistruar ankesa dhe dokumentacionin se si është marrë ankesa.



- Kutia e ankesave duhet të vendoset në një vend i cili është i arritshëm për të gjithë personat që marrin shërbime në SHMFF dhe ku një ankesë mund të hidhet pa u parë nga persona të tjerë.

Tajtimi i ankesave

- Ankesa merren në shqyrtim menjëherë sapo raportohen dhe trajtohen për të zgjidhur në

mënyrën më optimale të mundshme, sidomos kur bëhet fjalë për shërbime ndaj fëmijëve.



BASHKIA KORÇË

- Në rastet kur fëmijët/ përfituesit kanë ankesë për autoritetet apo politikat e ndjekura nga shërbimi i SHMFF, ato mund ta drejtojnë ankesën edhe pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashki apo Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social. Në këtë rast ato e postojnë ankesën pranë këtyre institucioneve. Një kopje e kësaj politike duhet të jetë e afishuar në mjediset që përdoren kryesisht nga pjesëmarrëset.



Shtojca 4: Udhëzime për përdorimin e imazheve të fëmijëve/të rriturve

Rreziqet

Përdorimi publik i imazheve dhe historive të fëmijëve/të rriturve paraqet rreziqe të mundshme të lidhura me mbrojtjen. Imazhet që përmbajnë informacione personale mund të përdoren si një mjet për të identifikuar fëmijët/të rriturit, për të krijuar kontakte me ta në distancë apo edhe për t'i gjurmuar se ku jetojnë.

- Imazhet mund të ndryshohen ose përshtaten për përdorim të papërshtatshëm.
 - Shfaqja dhe përdorimi i imazheve, historive të papërshtatshme, ose imazheve dhe historive për të cilat nuk është marrë pëlqimi dhe leja është joetike dhe mund të çojë në rritje të rreziqeve së SHMFF, siç është dëmtimi i reputacionit.
1. Informacion personal për një fëmijë/të rritur (të tilla si emri i plotë dhe data e lindjes ose emrat e plotë të anëtarëve të familjes) dhe informacioni që mund të përdoret për të identifikuar vendndodhjen e tij / saj specifike brenda një vendi (të tilla si emri i fshatit ose komunitetit, shkollës, kishës apo xhamisë, etj.) nuk duhet të përdoren, veçanërisht kur kjo është e lidhur me një imazh. Informacioni maksimal i dhënë për një fëmijë/të rritur duhet të jetë emri dhe emri i rrethit në të cilin ai jeton.
 2. Fëmijët/të rriturit që kanë përjetuar dhunë, shfrytëzim, janë abuzuar ose ndodhen në një situatë vulnerabël ose nëse identifikohen në rrezik, nuk duhet të shfaqen imazhet apo të dhënat që mund të çojnë në identifikim e tyre. Përveç kësaj, emrat e tyre të vërtetë duhet të ndryshohen dhe ky ndryshim të tregohet. Detajet e tjera identifikuese gjithashtu duhet të ndryshohen.
 3. Imazhet e fëmijëve/të rriturve të paveshur/ose të paveshur mirë nuk duhet të prezantohen në formën që mund të interpretohet si seksuale ose në mënyra që mund të ndikojnë negativisht dinjitetin dhe privatësinë e tyre.
 4. Të gjitha imazhet dhe historitë, së bashku me detajet shoqëruese të individëve, duhet të përdoren dhe mbahen në përputhje me ligjet e të dhënave përkatëse dhe të privatësisë. Rekomandohet që: imazhet të ruhen në mënyrë të sigurt (p.sh. kasaforta / dollapi i mbyllur, skedarët elektronikë të mbrojtur me fjalëkalim, hyrja e kufizuar etj.); dhe imazhet shkatërrohen dy vjet pas datës në formularin e pëlqimit/miratimit përveç nëse miratohet pëlqimi i mëtejshëm.

Pëlqimi/Miratimi

1. Miratimi i informuar, i fëmijës dhe prindit / kujdestarit apo të rriturit vulnerabël duhet të merret gjithmonë përpara se të bëhet dhe përdoret një fotografi ose imazh i një fëmije/të rrituri, dhe

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

shpjegohet përdorimi (et) e tij i synuar dhe / ose i mundshëm. Implikimet e përdorimit të imazheve, përfshirë rreziqet dhe pasojat e mundshme negative, veçanërisht kur imazhet e përdorura në faqet e internetit duhet gjithashtu të shpjegohen plotësisht. Format e pëlqimit për përdorimin e fotove/imazheve në formë miqësore duhet të përdoren për të siguruar pëlqimin e fëmijëve dhe ku është e mundur të tregohen fëmijës ose familjarëve/të rriturve imazhet/fotot përpara se ato të publikohen.

2. Fotografi në grup: ashtu si me fotografitë individuale, duhet t'i shpjegohet grupit se për çfarë do të përdoren fotografitë dhe të kërkohet pëlqimi nga individët në grup. Çdo individ që dëshiron të mos marrë pjesë duhet të lejohet ta bëjë këtë.
3. Fotografi të përgjithshme: kur përdorni imazhe të fëmijëve apo të rriturve në vende me shumë persona, ku mund të jetë e vështirë ose e pamundur të merrni pëlqimin/miratimin, duhet të merren parasysh sa vijon:
 - A presin fëmijët/të rriturit që gjatë eventit do bëhen foto?
 - A e konsiderojnë fëmijët që janë fotografuar ndoshta në një vend publik, pa patur pritshmëri e të qenit në një vend privat?
 - A ka gjasa që dikush ta kundërshtojë bërjen e fotos? (Dikush mund të jetë në një hapësirë publike por nuk dëshiron që imazhi i tij të përdoret). Kur fotografitë janë duke u bërë në një ngjarje të planifikuar, për aq sa është e mundur, individëve duhet t'u thuhet paraprakisht se do të përdoren kamerat dhe si do të përdoren fotografitë, në mënyrë që ata të mund të heqin dorë nga ngjarja ose të njoftojnë organizatorët se nuk dëshirojnë të paraqiten në ndonjë fotografi.



BASHKIA KORÇË

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)

Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

Shtojca 5: Deklarata për stafin dhe konsulentët e SHMFF KORÇË

Të shtohet në kontratën e punësimit ose konsulencës:

- Unë kam lexuar dhe kuptuar Politikën e Mbrojtjes të SHMFF Korçë dhe Procedurat dhe Udhëzimet shoqëruese.
- Pajtohem të respektoj politikat dhe procedurat e mbrojtjes të SHMFF Korçë.
- Unë gjithashtu deklaroj se kam ndarë me SHMFF Korçë çdo çështje që mund të shkaktojë shqetësime për mbrojtjen e fëmijëve/të rriturve në situata vulnerabël, reale ose të perceptuar, në lidhje me përshtatshmërinë time për punësim ose konsulencë. Unë konfirmoj që nuk kam ndjekje penale në pritje, dhe as nuk jam dënuar më parë për ndonjë vepër që ka të bëjë me sjellje të papërshtatshme me fëmijë apo të rritur vulnerabël.

Emri dhe Firma

Data



BASHKIA KORÇË

Shtojca 7: Deklarata për vizitorët

Deklarata për Vizitorët SHËRBIMET MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN BASHKIA KORÇË

Unë _____, si vizitor i qendrës ditore / zyrës / komunitetit e kuptoj rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të përfituar gjatë vizitës në mjediset e qendrës, në mënyrë që të mbroj sigurinë e shërbimit, përfituesve dhe stafit të saj.

Unë do të ruaj konfidencialitetin e informacionit përfitues në lidhje me shërbimet e ofruara nga Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen dhe nuk do t'i jap askujt asnjë informacion personal që kam përftuar në kontekstin e vizitës.

Unë nuk do të ndaj asnjë informacion mbi përfituesit, stafin ose funksionimin e shërbimit të urgjencës me palë të treta si media, të afërmit, përfaqësuesit e organeve publike ose private. Përrjashtim mund të jenë rastet kur ka një pëlqim të shkruar, nga prindërit ose kujdestarët e tyre.

Në lidhje me konfidencialitetin e përfituesve të programeve të SHMFF Korçë, personelit dhe aktiviteteve të tij, unë do u drejtoj çdo pyetje ose shqetësim përgjegjësit të SHMFF Korçë.

Emri Mbiemri

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Firma

Data

Shtojca 8: Termat e referencës për pikën e kontaktit për politikat e mbrojtjes

Termat e referencës për pikën e kontaktit për politikat e mbrojtjes për individët që ofrojnë shërbime sociale

Përshkrimi i rolit

Nën kujdesin e Drejtuesit të tij/saj të Burimeve Njerëzore, Drejtorit, pika e kontaktit për Politikën Mbrojtëse do të koordinojë zbatimin e tyre.

Përcaktimi i pikës së kontaktit është një rol ose "kapelë" dhe jo domosdoshmërisht një pozicion. Ky rol mund t'i caktohet personelit ekzistues ose mund të punësohet personel i ri për ta kryer atë. Nëse roli është një ndërmarrje me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme varet nga nevojat specifike brenda strukturës së SHMFF. Brenda SHMFF-së ekziston një pikë kontakti për të kryer këto përgjegjësi, i cili është kordinatori i shërbimit. Pika e kontaktit për Mbrojtjen e caktuar është përgjegjëse për të dëgjuar çdo shqetësim të abuzimit të fëmijëve/të rriturve në situatë vulnerabël në SHMFF, dhe më pas për t'u marrë me ato shqetësime. Pikat e kontaktit caktohen në mënyrë që fëmijët/ të rriturit të kenë përvojën e një të rrituri të besuar, kështu që ata të kenë mundësinë të dëgjohen nëse duan të bëjnë një ankesë. Pika e kontaktit është caktuar zyrtarisht sipas profilit të tyre përkatës të shërbimit dhe strukturës së menaxhimit për të siguruar nivelin e nevojshëm të vendimmarrjes për të përmbushur përgjegjësitë e rolit. Kurdoherë që është e mundur duhet të merret në konsideratë zgjedhja e personelit operacional dhe të burimeve njerëzore.

Projekti: "Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare" (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)



BASHKIA KORÇË

Detyrat kryesore të brendshme dhe përgjegjësitë

Brenda entitetit të tij / saj, Pika e kontaktit do të promovojë në mënyrë aktive mbrojtjen nga çdo lloj abuzimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve/të rriturit nga personeli që siguron mbështetje dhe shërbime sociale për të gjithë përfituesit e SHMFF Korçë. Në këtë drejtim, pika e kontaktit:

- Merrni një rol udhëheqës në ndërgjegjësimin mbi masat e mbrojtjes së fëmijëve/të rriturve të SHMFF Korçë, përfshirë Kodin e Sjelljes dhe politikat e tjera të brendshme;
- Sigurohuni që i gjithë stafi i SHMFF Korçë, të zbatojë çdo program në përputhje me rrethanat, duke integruar masat e mbrojtjes së fëmijëve/të rriturve në secilin aktivitet të kryer;
- Merrni dhe adresoni të gjithë informacionin mbi çdo shqetësim të mbrojtjes së fëmijëve/të rriturve vulnerabël; të sigurojë që të gjitha informacionet regjistrohen në format e dedikuara dhe i referohen ekipit të duhur të menaxhimit;
- Planifikoni dhe merrni pjesë në çdo hetim në lidhje me incidentet;
- Sigurohuni që të gjithë përfituesit janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre për mbrojtje dhe masat e mbrojtjes së SHMFF Korçë dhe Kodin e Sjelljes;
- Vlerësoni nivelin e rreziqeve të mbrojtjes së fëmijëve/të rriturve brenda shërbimeve që ofrohen;
- Konsultohuni me agjencitë lokale mbi rrugët e referimit për përgjigjet e Politikave të Mbrojtjes; rifreskoni mënyra të reja të kanalizimit dhe mbledhjes së informacionit në lidhje me ofrimin e shërbimeve.

Kompetencat dhe eksperiencia

Pika e kontaktit për Politikën e Mbrojtjes do të jetë një anëtar i stafit që së brendshmi do të quhet përgjegjësi i shërbimit. Pika e kontaktit ka nevojë për akses në çdo hallkë të shërbimit dhe në nivel drejtues në mënyrë që të jetë në gjendje të përmbushë përgjegjësitë e rolit. Prandaj, pika e kontaktit zakonisht emërohet brenda strukturës së menaxhimit të shërbimit. Pika e kontaktit duhet të ketë këto kompetenca dhe eksperiencia: njohuri dhe përvojë të thellë në lidhje me politikën, strukturat dhe mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve/të rriturve; kapacitetin për të ruajtur konfidencialitetin mbi informacionin dhe komunikimin; aftësi të mira komunikimi dhe marrëdhënie; demonstrojë ndjeshmëri ndaj diversitetit kulturor dhe çështjeve gjinore; të aftë në analizimin e nevojave për ndërtimin e kapaciteteve dhe ndërhyrjen.

Mbështetja dhe burimet për pikën e kontaktit

Shumë mekanizma dhe procedura që pika e kontaktit është përgjegjëse për ti zhvilluar, janë tashmë të zhvilluar nga të tjerë, në vend apo në shtete të tjera. Si të tilla, pika e kontaktit duhet të përfitojë nga instrumentet ekzistuese dhe manual për të shmangur duplikimin.